



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.87/2025

**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët : Bujar Muzaqi kryesues, Hajriz Hoti dhe Kujtim Pasuli anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 24.01.2025, merr këtë:

**V E N D I M**

- I. Pranohen të bazuara ankesat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, Anr.87/2025, Anr.110/2025, Anr.111/2025, Anr.112/2025, Anr.113/2025, Anr.114/2025, të datës 21.01.2025.
- II. Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 10.500,00 Euro (dhjetëmijëepesqind) Euro.
- III. Detyrohet Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Komuna Prishtinë, që gjorbën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

**A r s y e t i m**

Me datë 21.01.2025 PZAP-i ka pranuar ankesat e identifikuara me numër Anr.87/2025, Anr.110/2025, Anr.111/2025, Anr.112/2025, Anr.113/2025, Anr.114/2025, të parashtruara nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë

- Në ankesën Anr.87/2025, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, LVV, pretendon se më datë 20 janar 2025, aktivistë të Lëvizjes Vetëvendosje, kanë vërejtur se në rrugën "Nënë Tereza", disa kandidatë për deputetë nga lista e Partisë Demokratike të Kosovës, ndër ta; kandidatja znj Eliza Hoxha, kandidati z. Bernard Nikaj dhe kandidati me numër 50 në listën e PDK-së,

shfrytëzojnë jashtëligjshëm dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore lidhur me mbarëvajtjen e zgjedhjeve, hapësirat publike, konkretisht hapësirat në stacionet e destinuara për pritje të autobusëve. Më tutje parashtruesi i ankesës thekson se ka kërkuar nga organi kompetent që ka në menaxhim këto hapësira, konkretisht sektori për Shërbime Publike në Komunën e Prishtinës, dhe të cilët kanë njoftuar se subjekti politik PDK, nuk posedon leje përkatëse për shfrytëzimin e këtyre hapësirave dhe drejtoria e shërbimeve publike si organ komunal, nuk ka lëshuar ende asnjë leje përkatëse për reklamim. Në ankesë theksohet se me këtë veprim janë shkelur dispozitat ligjore të nenit 34, paragrafi 1 nënpar.1.2 i Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Si provë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi që dëshmon vendosjen e posterëve, dhe komunikimin përmes emailit me Zyrën e Komunikimit të Komunës së Prishtinës.

-Në ankesën Anr.110/2025, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, LVV, pretendon se më datë 20 janar 2025, aktivistë të Lëvizjes Vetëvendosje, kanë identifikuar banerët/posteret e vendosur në hapësirat/rrugë publike të kandidatëve për deputetë të PDK-së, Memli Krasniqi, Bedri Hamza si dhe shenja identifikuese zgjedhore e PDK-së me numër 131 në rrugën “ Fehmi Lladrovc”, me të cilin veprim kandidatët dhe subjekti politik PDK kanë bërë shkelje të nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Si provë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi që dëshmon vendosjen e posterëve, dhe komunikimin përmes emailit me Zyrën e Komunikimit të Komunës së Prishtinës.

-Në ankesën Anr.111/2025, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, LVV, pretendon se më datë 20 janar 2025 aktivistë të Lëvizjes Vetëvendosje, kanë identifikuar banerët/posteret e vendosur në hapësirat/rrugë publike të kandidatëve për deputetë të PDK-së, Mimoza Ahmetaj, Ilirik Musliu, dhe kandidatja me numër 41 nga radhët e PDK-së, në Bulevardin “ Dëshmoret e Kombit”, në Prishtinë me të cilin veprim kandidatët dhe subjekti politik PDK kanë bërë shkelje të nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Si provë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi që dëshmon vendosjen e posterëve dhe komunikimin përmes emailit me Zyrën e Komunikimit të Komunës së Prishtinës.

-Në ankesën Anr.112/2025, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, LVV, pretendon se më datë 20 janar 2025, aktivistë të Lëvizjes Vetëvendosje, kanë identifikuar banerët/posteret e vendosur në hapësirat/rrugë publike të kandidatëve për deputetë të PDK-së, Pleurat Sejdiu, Ferat Shala dhe Ariana Musliu Shoshi dhe shenja identifikuese me numrin zgjedhor 131 PDK, në rrugën “Idriz Seferi”, në Prishtinë, me të cilin veprim kandidatët dhe subjekti politik PDK kanë bërë shkelje të nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Si provë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi që dëshmon vendosjen e posterëve, dhe komunikimin përmes emailit me Zyrën e Komunikimit të Komunës së Prishtinës.

-Në ankesën Anr.113/2025, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, LVV, pretendon se më 20 janar 2025 aktivistë të Lëvizjes Vetëvendosje, kanë identifikuar banerët/posteret e vendosur në hapësirat/rrugë publike të kandidatëve për deputetë të PDK-së, Bedri Hamza, Ariana Musliu Shoshi dhe shenja identifikuese me numrin zgjedhor 131 PDK, në rrugën “ Luan Haradinaj”,

në Prishtinë, me të cilin veprim kandidatët dhe subjekti politik PDK kanë bërë shkelje të nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Si provë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi që dëshmon vendosjen e posterëve dhe komunikimin përmes emailit me Zyrën e Komunikimit të Komunës së Prishtinës.

-Në ankesën Anr.114/2025, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, LVV, cilën pretendon se më 20 janar 2025 aktivistë të Lëvizjes Vetëvendosje, kanë identifikuar banerët/posteret e vendosur në hapësirat/rrugë publike të kandidatëve për deputetë të PDK-së, Vlora Çitaku, Uran Ismaili, dhe Ilirik Musliu, në rrugën " Migjeni", në Komuna Prishtinë, me të cilin veprim kandidatët dhe subjekti politik PDK kanë bërë shkelje të nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Si provë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi që dëshmon vendosjen e posterëve dhe komunikimin përmes emailit me Zyrën e Komunikimit të Komunës së Prishtinës.

Në përgjigjen në ankesë subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, ka kërkuar nga PZAP që ankesat e ankuesit ti refuzoj si të pabazuara për arsye se Partia Demokratike e Kosovës, në momentin e vënies në dijeni për këto pretendime ankimore, zyrtarisht ka bërë kërkesë për sqarime dhe informata në Komunën e Prishtinës, respektivisht në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, të cilët në përgjigjen e tyre zyrtare, përmes udhëheqësit të sektorit për shërbime z. Habib Qorri, kanë konfirmuar zyrtarisht se Komuna e Prishtinës ka nënshkruar dhe është duke zbatuar kontratën me OE "Selmans Network" Sh.P.K, për furnizimin dhe montimin e pritoreve për vend ndalje të autobusëve në kryeqytet. Në bazë të përgjigjes zyrtare të Komunës së Prishtinës, zyrtari përgjegjës i saj ka konfirmuar se në bazë të kontratës së lartcekur, OE ka për obligim mirëmbajtjen dhe menaxhimin për 3 vite të vend ndaljeve të autobusëve urban në kryeqytet, duke përfshirë këtu edhe hapësirat reklamuese të kryeqytetit.

Parashtruesi i përgjigjes në ankesë ka theksuar se PDK duke qenë në dijeni të faktit se OE "Selmans Network" Sh.P.K ka kontratë valide me Komunën e Prishtinës, për qëllime të marrjes së lejes për shfrytëzimin e hapësirës publike, e njëjta përmes lidhjes së kontratës më datë 11.01.2025, ka marrë pëlqimin nga shfrytëzuesi i këtyre hapësirave, për qëllime të hapësirave reklamuese të partisë dhe kandidatëve të saj përgjatë periudhës së fushatës zgjedhore. Rrjedhimisht, përmes lidhjes së kësaj kontrate me operatorin përgjegjës për administrimin e hapësirave publike në kryeqytet, PDK në mënyrë ligjore ka rregulluar çështjen e shfrytëzimit të hapësirave të specifikuar si në ankesat e ankuesit, prandaj Komuna e Prishtinës nga organi kompetent përgjegjës i saj, ka konfirmuar kontratën e saj me operatorin ekonomik, dhe të drejtën e këtij të fundit që të menaxhoj këto hapësira, duke përfshirë pos të tjerash edhe përmes lidhjes së kontratave me palët e treta si në rastin konkret me PDK, prandaj subjekti politik PDK ka plotësuar të gjitha kushtet ligjore për shfrytëzimin e hapësirave reklamuese në hapësirat publike, pasi që e njëjta paraprakisht ka merre leje tek shfrytëzuesi apo pronari i kësaj hapësire, respektivisht nga Operatori Ekonomik "Selmans Network" Sh.P.K.

Po ashtu parashtruesi i përgjigjes në ankesë ka theksuar se në rrethanat e rastit konkret si në ankesat e parashtruara nga ana e ankuesit, Partia Demokratike e Kosovës ka ndërmarrë masa paraprake, respektivisht ka marrë pëlqimin nga shfrytëzuesi i këtyre hapësirave, me qëllim të

shfrytëzimit së të njëjtave për qëllime të reklamimit të kandidatëve nga subjekti i saj, e të cilat në asnjë mënyrë nuk përbëjnë shkelje nga neni 34, par. 1, nën paragrafi . 1.2 i LZP-së

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr.01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-it, dhe neni 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat A.nr.87/2025, A.nr.110/2025, A.nr.111/2025, A.nr.112/2025 A.nr.113/2025, A.nr.114/2025, të paraqitura me datë 21.01.2025, dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët A.nr.80/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankuesve.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesat, gjeti se:

**-Ankesat janë të bazuara.**

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndëve dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga Subjekti Politik PDK, vlerësoj se pretendimet e Subjektit Politik LVV, janë të qëndrueshme dhe si të tilla i aprovoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se *“Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve.”*

Në përgjigje në ankesë të Subjektit Politik PDK, referuar disa prej kandidatëve për deputet nga ky subjekt, pretendohet se për vendosjen e materialeve reklamuese-postereve posedojnë Kontratë me Operatorin Ekonomik Selman Network, SH.P.K, me nr.Prot.01/2025, datë 11 Janar 2025, e bashkangjitur si provë në përgjigje në ankesë.

Paneli gjatë shqyrtimit të provave gjegjësisht Kontratës së PDK-së me Operatorin Ekonomik Selman Network, SH.P.K, me nr.Prot.01/2025, të datës 11 Janar 2025, ka vërejtur se e njëjta kontratë nuk përmban asnjë të dhënë se operatori ekonomik në fjalë të ketë lidhë ndonjë kontratë me Komunën e Prishtinës për shfrytëzimin e këtyre hapësirave publike reklamuese, përkatësisht për të pasur të drejtë që të njëjtat hapësira reklamuese t’ia bartë personit të tretë. Nga komunikimi elektronik që përmban emrin Arlinda Kastrati, Zyra për Komunikim Publikë të Kabinetit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, drejtuar Ermal Osmani, datë 13.01.2025, paneli vëren se Sektori për Shërbime Publike nuk posedon ndonjë kontratë për hapësirat reklamuese në pritoret a autobusëve. Gjithashtu, nuk është lëshuar asnjë leje për shfrytëzimin e hapësirave të tjera publike për reklamim. Po ashtu nga komunikimi elektronik në mes të Habib Qorri, udhëheqës i Sektorit Për Shërbime Publike në Komunën e Prishtinës, drejtuar Donat Lushaku, është pohuar se ekziston Kontrata publike Kornizë Publike – Furnizime datë 30.10.2019, e lidhur në mes të Komunës së Prishtinës në njëjërë anë, dhe Selman Network sh.p.k, në anë tjetër e cila është ende në fuqi dhe realizim. Pas konsultimit me menaxherin e kontratës, pritoret janë furnizuar dhe montuar nga shtatori i vitit të kaluar 2024 në kryeqytet, ku në bazë të kontratës pas furnizimit, montimit dhe funksionalizimit të pritoreve, operatori ekonomi Selman Network sh.p.k ka për obligim mirëmbajtjen dhe menaxhimin e tyre dhe për tri vite, përfshirë këtu edhe hapësirën reklamuese.

Marrë për bazë përgjigjet e tilla kundërthënëse për raportin kontraktues mes tyre, përkatësisht të drejtat dhe detyrimet nga ky raport, PZAP me datë 23.01.02025 ka kërkuar sqarime nga

Komuna e Prishtinës. Komuna e Prishtinës përkatësisht Drejtoria për Shërbime Publike dhe Shpëtim ka dhënë përgjigje në kërkesë, ku ndër tjera ka theksuar se: *“Sektori për shërbime Publike, nuk ka lëshuar dhe nuk posedon ndonjë kontrate për hapësirat reklamuese ne pritore e autobusëve. Gjithashtu nuk është lëshuar leje nga ky për shfrytëzimin e këtyre hapësirave publike reklamuese...”*.

Nga arsyet e parashtruara konstatohet se Selman Network sh.p.k nuk ka pasur kontratë të vlefshme me Komunën e Prishtinës për shfrytëzimin e pritoreve dhe hapësirave të tjera, dhe rrjedhimisht nuk ka pasur mundësi që një të drejtë të tillë t’ia bartë tjetrit, në këtë rast subjektit politik PDK. Mbi këtë bazë është vlerësuar se kontrata e lidhur mes operatorit ekonomik Selman Network sh.p.k dhe subjektit politik PDK nuk mund të prodhoj efekt juridik në kuptim të krijimit të bazës për shfrytëzim të këtyre hapësirave, përkatësisht vendosjen e posterëve, sepse për vendosjen e posterëve nevojite të merret leja nga organet kompetente Komunale.

Paneli ka vlerësuar se vendosja e postereve nga subjekti politik PDK respektivisht kandidatet e këtij subjekti në hapësirat publike, në mungesë të lejes përkatëse të lëshuar nga Komuna e Prishtinës i konsideron si shkelje të nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes, dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se ky veprim i tyre përbën përsëritje të shkeljes së legjislacionit zgjedhor, pra ka bërë shkelje të tilla edhe në proceset e mëparshme zgjedhore, po ashtu edhe në këtë proces zgjedhor. Kjo konsiston në faktin se Subjekti Politik PDK, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës zgjedhore. Andaj përfshirja e posterëve të subjektit të tyre politik për fushatë zgjedhore në hapësira publike gjegjësisht në rrugët publike për të cilat nuk posedojnë Pëlqim nga Komuna e Prishtinës, përbën shkelje të legjislacionit zgjedhor, saktësisht e sanksionuar me dispozitën saktësisht e sanksionuar me dispozitën e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe të njëjtit subjekt politik për të njëjtën shkelje i është shqiptuar gjobë nga PZAP gjatë këtij procesi zgjedhor.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nënin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës  
Anr.87/2025 më datën 24.01.2025



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.